



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI

Nr. 2048 / prot  
16

Koplik më: 23 / 07 / 2021

**V E N D I M**

*Nr 44 datë 16 / 07 / 2021*

**PËR**

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Valentin Çekaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit. si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit z. Valentin Çekaj nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 2 datë 11.01.2021 "për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afat mesem 2021-2023 të Bashkisë Malësi e Madhe".

**Baza Ligjore**

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

**Vendosi;**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Valentin Çekaj, objekti shtëpi banimi e të cilës është dëmtuar nga rënia e zjarrit,.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për demtimin e banesë nga rënia e zjarrit.
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Valentin Çekaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.2, datë, 11.01.2021 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 të Bashkisë Malësi e Madhe" ,nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280".
4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit Z. Valentin Çekaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Z. Valentin Çekaj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

6. Ndhurma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z. Valentin Çekaj**, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orëndi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 280.900 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nentëqind) leke.

Dëmtime nga ana ndërtimore me vlerë 2.154.281 (dy milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lek

Vlera në total e dëmeve është : 2.435.181 (dy milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) leke.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 16.07.2021

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 23.07.2021

